



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr. 31/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtari Arnis Dumani, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit G... Sh.p.k., me numër unik identifikues, me seli në Mitrovicë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson B.M, kundër të paditurit Ministria e Punëve të Brendshme, me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson H.K, për shkak të anulimit të vendimit KV. nr. 124/18 të datës 03.10.2018, pas shqyrtimit kryesor publik të mbajtur me datë 12.09.2022 në prezencë përfaqësuesve të autorizuar të palëve, me datë 25.09.2022 merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit G... Sh.p.k., me të cilën ka kërkuar anulimin e vendimit KV. nr. 124/18 të datës 03.10.2018 të nxjerrë nga i padituri Ministria e Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Paditësi G... Sh.p.k., ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të Komisionit për Vendosje në kuadër të Policisë së Kosovës KV.nr. 1246/2018 i datës 03.10.2018 si jo i ligjshëm, me arsyetimin se e paditura nuk ka arritur ta vërtetoj drejtë gjendjen faktike lidhur me konstatimin e peshës boshtore si dhe llojin e ngarkesës, pasi që kamioni me ngarkesë ka hyrë përmes procedurave doganore dhe e tërë ngarkesa ka qenë brenda peshës së lejuar ashtu që në kamion ka pasur ngarkesë prej 39,680 kg bruto, ndërsa malli i ngarkuar ka qenë në peshë 21,760 kg, të cilat pesha janë brenda peshës së përcaktuar me rregullore e cila lejon ngarkesën deri në 40,000 kg bruto. Gjithashtu ka theksuar se të gjitha këto dëshmohen përmes faturës së ngarkesës, fletëpeshoren e shitësit dhe SP deklaratën e doganës në hyre. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka theksuar se e paditura gabimisht ka konstatuar se kamioni ka qenë i ngarkuar me blloka, pasi që i njëjti ka qenë i ngarkuar me shufra çeliku – armaturë dhe brenda peshës totale të lejuar, andaj gjykatës i ka propozuar që të aprovohet padia e paditësit ashtu që të anulohet në tërësi vendimi i të paditurës dhe fletëparaqitja e datës 22.09.2018

I padituri me përgjigje në padi e ka kontestuar në tërësi padinë e paditësit duke theksuar se vendimi i të paditurës është i drejtë dhe i ligjshëm dhe i njëjti është nxjerrë pas vlerësimit të gjitha rrethanave si dhe kundërshtimit të paditësit, nga ku i padituri ka konstatuar se paditësi ka tejkalluar peshën boshtore dhe për këtë konsiderohet përgjegjës për kundërvajtje andaj ka konsideruar se dënimi i shqiptuar është dënim i bazuar dhe këtu paditësit i është shqiptuar dënim minimal i përcaktuar me ligj lidhur me kundërvajtjen e kryer. Në seancën e shqyrtimit kryesor ka theksuar se fletëparaqitja është bazuar në nenin 4 par.3 të Ligjit për Automjetet e cila dispozitë sanksionin edhe tejkalimin e peshës boshtore përveç asaj të përgjithshme dhe se zyrtarët e Ministrisë së Infrastrukturës matjen e kanë kryer me pajisje të certifikuar për matjen e peshave ashtu që në dy nga pesë boshtet e mjetit transportues është konstatuar tejkalim i peshës boshtore, përkatësisht në boshtin 3 është tejkalluar për 4.2 ton më shumë se sa pesha e lejuar dhe në boshtin 4 është tejkalluar për 2.03 ton më shumë se sa pesha e lejuar, prandaj gjykatës i ka propozuar që të refuzohet në tërësi kërkesëpadia e paditësit dhe të mbetet në fuqi vendimi i Komisionit për Vendosije.

Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Faturë shitje tatimore nr. 10094 e datës 21.09.2018, dokument i lëshuar nga Dogana e Kosovës nr. 600242010/003, Vendimi KV.nr. 1246/18 i datës 03.10.2018, proces nr. 001197 mbi kontrollimin e ngarkesës së automjetit transportues i datës 22.09.2018, fletëparaqitje për kundërvajtje në trafik nr. SHQ5A000219994K e datës 22.09.2018.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së, provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, pretendimeve të palët ndërgjyqëse në seancë, thënieve në padi dhe përgjigjen në padi të së paditurit si dhe pas shqyrtimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar.

I Padituri përmes Fletëparaqitjes për Kundërvajtje në trafik SHQ5A000219994K të datës 22.09.2018, paditësit i ka shqiptuar gjobën në shumë prej 600€ për shkak të tejkalimi të peshës boshtore sipas matjes me peshore nga Ministria e Infrastrukturës.

Paditësi i pa kënaqur me fletëparaqitjen, ka ushtruar ankesë në Komisionin për Vendosije pranë Policisë së Kosovës, të cilët me Vendimin KV.nr.1246/2018 të datës 03.10.2018 kanë refuzuar kundërshtimin e paraqitur nga G... Sh.p.k. dhe është vërtetuar vendimi i goditur si i drejtë dhe i ligjshëm.

Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 64 par. 1 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje i cili përcakton: “*Kundër vendimit përfundimtar për*

kundërvajtje, të cilën e ka nxjerrë organi i kundërvajtjes, mund të paraqitet padia për zhvillimin e kontestit administrativ. Padinë mund ta paraqes personi (fizik ose juridik), ndaj të cilit i është shqiptuar sanksioni, përfaqësuesi i tij ligjor, përkatësisht mbrojtësi, i dëmtuari dhe përfaqësuesi i tij, si dhe pronari i sendit të konfiskuar/marrë dhe në procedurën e kundërvajtjes” si dhe në kuptim të par. 4 që përcakton se: “Gjykata kompetente që të vendosë për konfliktin administrative procedurën e mbrojtjes gjyqësore e zhvillon sipas Ligjit për Konfliktet Administrative.” Po ashtu gjykata iu referua edhe nenit 66 par.1 që përcakton: “Vendimi i organit kundërvajtës mund të kontestohet me padi: 1.1. nëse me vendim ka qenë shkelur dispozita materiale e ligjit, me të cilën është paraparë kundërvajtja; 1.2. nëse janë shkelur dispozitat e procedurës, sepse nuk ka vendosur organi kompetent ose nëse vendimi nuk i ka të gjitha elementet përbërëse të parapara; 1.3. për shkak të përcaktimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me ç’rast në padi nuk mund të theksohen faktet e reja dhe të propozohen prova të reja, nëse paditësi gjen se me siguri pa fajin e tij nuk ka qenë e mundshme që t’i propozojë në procedurë, dhe; 1.4. për shkak të sanksioneve të shqiptuara, konfiskimit të sendeve dhe shpenzimeve të procedurës.”

Gjykata i vlerësoi të pabazuara pretendimet e paditësit sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga i padituri në procedurë administrative dhe në kundërshtim me provat e administruara. Gjykata nga prova Faturë shitje tatimore nr. 10094 e datës 21.09.2018 ka konstatuar se kamioni me targa 653 KS 070 është ngarkuar me peshë prej 21,760kg. Gjithashtu nga prova dokument i lëshuar nga Dogana e Kosovës nr. 600242010/003, gjykata ka konstatuar se kamioni me targa 653 KS 070 ka qenë i ngarkuar me shufra çeliku në peshë 21,760 kg. Nga prova Proces nr. 001197 mbi mbi kontrollimin e ngarkesës së automjetit transportues i datës 22.09.2018 gjykata ka konstatuar se kamioni transportues me targa 653 KS 070 sipas matjeve të bëra nga Departamenti i Menaxhimit të Rrugëve i Ministrisë së Infrastrukturës, pesha boshtore ka qenë si në vijim: në boshtin 1 ka rezultuar pesha 6.4 ton nga 10 ton sa është e lejuar, në boshtin 2 ka rezultuar pesha 9.7 ton nga 11,5 ton sa është e lejuar, në boshtin 3 ka rezultuar pesha 12.2 ton nga 8 ton sa është e lejuar ashtu që është tejkualuar pesha prej 4.2 ton, në boshtin 4 ka rezultuar pesha prej 10 ton nga 8 tonë sa është e lejuar ashtu që është tejkualuar pesha prej 2 ton dhe në boshtin 5 ka rezultuar pesha prej 7.8 ton nga 8 ton sa është e lejuar.

Gjykata vlerëson se nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit lidhur me konstatimin mbi kontrollimin e ngarkesës së automjetit transportues si dhe Fletëparaqitjes për Kundërvajtje në trafik SHQ5A0000219994K të datës 22.09.2018. Gjithashtu gjykata e ka vlerësuar si të drejtë

arsyetimin e Komisionit për Vendosje se në këtë rast, gjoba kundërvajtëse është shqiptuar lidhur me tejkalimin e peshës boshtore.

Gjykata vlerëson se sipas nenit 4 par. 1 të Ligjit Nr. 05/L-132 për automjete përcaktohet se: *“Mjetet në trafikun rrugor duhet të plotësojnë kushtet lidhur me përmasën, dimensionet, masën më të madhe të lejuar, ngarkimin boshtor, si dhe të kenë instalimet dhe pajisjet e parapara, në gjendje të rregullt. Ministria, përcakton rregullat për dimensionet, ngarkesën boshtore, dhe masën më të madhe të lejuar.”* Në par. 2 të këtij nenit përcaktohet se *“Mjetet të cilat nuk i plotësojnë kushtet e parapara lidhur me përmasën, dimensionet, me masën më të madhe të lejuar dhe ngarkimin boshtor, mund të marrin pjesë në trafik rrugor publik nëse i plotësojnë kushtet e posaçme të cilat bëjnë të mundshme lëvizjen e sigurt sipas lejes së dhënë nga Komuna për rrugët lokale apo Ministria për rrugë regjionale dhe nacionale në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, varësisht se në territorin e së cilit marrin pjesë në trafik.”* Lidhur me kompetencën e Departamentit për Menaxhimit të Rrugëve për kontrollimin e ngarkesës boshtore par. 3 i nenit 4 përcakton: *“Punët operative të matjes, kontrollit të ngarkesës boshtore, masës së përgjithshme dhe dimensionet e mjetit në trafik në rrugë e bënë zyrtari i autorizuar për mbikëqyrjen e trafikut në rrugë publike”* Ndërsa lidhur me lartësinë e sanksionit kundërvajtës për shkeljen e lartë cekur në par. 5 përcaktohet se: *“Dënohet me gjobë gjashtëqind (600.00) € subjekti juridik ose institucioni në emër dhe brenda autorizimeve të së cilit vepron personi i lartpërmendur në paragrafin 2 të këtij neni.”*

Prandaj, gjykata vlerëson se Komisioni për Vendosje ka vepruar në përputhje me dispozitat e lartcekura kur ka vendosur që të refuzojë ankesën e paditësit kundër Fletëparaqitjes për Kundërvajtje në trafik SHQ5A0000219994K të datës 22.09.2018.

Gjykata po ashtu vlerësoi edhe pretendimet e të autorizuarit të paditësit të dhëna në padi dhe në seancën gjyqësore lidhur me faktin se e paditura gabimisht ka konstatuar llojin e ngarkesës në automjetin transportues, përkatësisht faktin se është konstatuar se ka pasur ngarkesë me blloka, ndërsa ka qenë i ngarkuar me shufra çeliku – armaturë si dhe pretendimet se pesha totale e automjetit transportues ka qenë 39,680kg ashtu që nuk e ka tejkaluar peshën prej 40,000 kg, por të njëjtat pretendime gjykata i vlerësoi si jo relevante për të nxjerrë një gjendje tjetër faktike nga ajo që i padituri e ka vërtetuar në procedurë administrative pasi që në këtë rast objekt trajtimi ka qenë tejkalimi i peshës boshtore ndërsa lloji i ngarkesës së mallit dhe ngarkesa e përgjithshme e automjetit transportues nuk kanë qenë objekt i trajtimit dhe me ndikim në kundërvajtjen e shqiptuar.

Prandaj, gjykata përfundimisht vlerëson se i padituri me rastin e refuzimit të ankesës së paditësit në procedurë administrative, ka vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe ka zbatuar dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe dispozitat tjera materiale të cituara më lartë.

Andaj, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.31/22, datë 25.09.2022

Gjyqtari

Arnis Dumani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 7 (shtatë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.